STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 11 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON HAPJEN E KUFIZUAR TE TUNELIT HJU L. KERI (HUGH L. CAREY) PER AUTOBUSAT GJATE ORES SE PIKUT

Rivendos lidhjen e rëndësishme per udhetarët e autobusit ekspres

Riparimet e sistemeve të dëmtuara të tunelit vazhdojnë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Tuneli Guvernatori Hju L. Keri (Hugh L. Carey), i njohur më parë si Tuneli Bruklin Bateri (Brooklyn Battery), do të rihapet të hënën në mëngjes për shërbimin e kufizuar të autobusave gjatë orës së pikut.

Autobusat ekspres të Autoritetit të Transportit Metropolitan (MTA) nga Bruklin (Brooklyn) dhe Stejtën Ajlënd (Staten Island) do të jenë në gjendje të përdorin një korsi të një tuneli për shërbimin e vajtjes nga 6 në mëngjes deri në 10 në mëngjes dhe për shërbimin e ardhjes nga 3 të pasdites deri në 7 të pasdites. Tuneli do të mbetet i mbyllur gjatë orëve të tjera, pasi ekipet vazhdojnë punën e tyre pa pushim për të riparuar dëmin e gjerë të përmbytjes.

“Pashë vetë përmbytjen e shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy) në Tunelin Keri (Carey) dhe rihapja e tij është një testament ndaj punës së madhe të punëtorëve të MTA-së pas stuhisë,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Tuneli i mbyllur ishte një bezdi për udhëtarët e Nju Jorkut dhe rihapja e tij shënon një hap tjetër në punën tonë për të restauruar infrastrukturën jetësore të transportit sa më shpejt që të jetë e mundur pas Uraganit Sendi (Sandy).”

Tuneli Keri (Carey) u përmbyt gjatë Uraganit Sendi (Sandy) me një sasi të vlerësuar në 43 milionë gallonë uji në secilën nga dy pjesët e tij. Uji i kripur shkaktoi dëmtim të gjerë të grryerjes në sistemet elektrike, të ndriçimit, komunikacioneve, mbikqyrjes dhe ajrimit në secilën pjesë.

Autobusat ekspres do të jenë në gjendje që të përdorin një korsi të tunelit lindor, i cili zakonisht transporton trafikun e drejtuar për në Manhatan. Korsia tjetër e atij tuneli është duke u përdorur për të vendosur pajisjet e riparimit dhe të rimëkëmbjes. Ndriçimi në tunel do të jetë i kufizuar dhe do të shtohet nga ndriçimi i emergjencës.

Tuneli perëndimor, që zakonisht transporton trafikun e drejtuar për në Bruklin, pësoi dëmtim më të gjerë dhe ende është duke u zbrazur nga uji në tubacionet e ajrit poshtë sipërfaqes së rrugës. Asnjë afat kohor nuk është i disponueshëm për rihapjen e tunelit perëndimor.

"Tuneli Hju L. Keri (Hugh L. Carey) është tuneli nën lumë për automjete më i gjati në Amerikën e Veriut dhe askush nuk është përballur ndonjëherë me një sfidë si kjo," tha Kryetari dhe CEO i MTA-së Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota). "Ishte i mbushur nga dyshemeja në tavan për më shumë se një milje me ujë dhe mbeturina. Fakti se tani është gati për shërbim të kufizuar për udhëtarët është një testament ndaj aftësisë dhe përkushtimit të punonjësve të Urave dhe Tuneleve të MTA-së që punojnë shumë."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418